



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

MINISTRI

Nr. 9888 Prot.

Tiranë, më 20/06/2015

URDHËR

Nr 7, Datë 20/6/2015

“PËR

PROCEDURAT E MBYLLJES SË LLOGARIVE TË NJËSIVE TË QEVERISJES
VENDORE QË DO TË SHKRIHEN”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014. “Për Buxhetin e vitit 2015”, ministri i Financave,

URDHËRON:

1. Transferta e pakushtëzuar (tremujori i III-të (10%) dhe tremujori i IV-të (10%)) për njësitë e qeverisjes vendore që do të shkrihen në kuadrin e reformës territoriale të çelet në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë më datë 01 korrik 2015.
2. Njësitë e qeverisjes vendore që do të shkrihen, të paguajnë deri në datën 07 korrik 2015 shpenzimet, dokumentacioni i të cilave përmban datën deri më 30 qershor 2015.
3. Të likuidohen shpenzimet për paga dhe të tjera të lidhura me to (si sigurimet shoqërore etj.), të muajit Qershor, brenda datës 07 korrik 2015.
4. Të ardhurat e njësive vendore të shkriura të papërdorura deri në datën 07 korrik 2015 do ti trashëgohen njësisë së re vendore.
5. Të ardhurat tatimore vendore për të cilat vepron si agjent administrata tatimore qendrore dhe institucione të tjera qendrore , të cilat shërbejnë si agjent tatimor do të rakordohen dhe alokohen deri më datë 07 korrik 2015. Fondet e papërdorura do ti kalojnë njësisë së re vendore.
6. Deri më datën 20 korrik 2015, degët e thesarit duhet të dërgojnë në Ministrinë e Financave (Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit), në mënyrë elektronike dhe në rrugë shkresore gjendjen e buxhetit (tepricën) nga transferata e pakushtëzuar, të ardhurat e veta dhe të tjera të ardhura për njësitë e qeverisjes vendore që do të shkrihen, si dhe detyrimet e prapambetura.
7. Nëpunësit autorizues dhe nëpunësit zbatues të njësive të qeverisjes vendore që do të shkrihen, kanë të drejtën e veprimit në degën e thesarit përkatëse për kryerjen e transaksioneve të mbylljes së llogarive vjetore deri më datë 10 korrik 2015.

8. Të gjitha njësitë e reja të qeverisjes vendore, brenda 5 ditëve nga konstituimi i tyre, duhet të paraqesin në Ministrinë e Financave shkresën për konfirmimin e Nëpunësve Autorizues dhe Nëpunësve Zbatues, sipas kërkesave ligjore në fuqi.

9. Çdo rast specifik, pas datës 10 korrik 2015, do të trajtohet rast pas rasti nga Ministria e Financave.

SHKËLQIM CANI

MINISTËR

